

Informacion për ju që duhet të regjistroni kompetencën tuaj

Ky është në informacion për ju që do regjistroni informacionët mbi kompetencën tuaj. Jeni të detyruar të i regjistroni informacionët dhe keni të drejtë të regjistroni informacionët tuaja krh Ligjin për integrim § 6.

Jeni të detyruar të regjistroni informacionet në lidhje me kompetencën tuaj. Mungesa e regjistrimit do të ketë ndikim në përshtatjen e udhëzimit që merrni në lidhje me arsimimin dhe punën në Norvegji, dhe në përmbajtjen e programit tuaj hyrës. Mungesa e regjistrimit mund të ndikoj gjithashtu në përpykjet e IMDI për të gjetur një komunë të përshtatshme për ju.

Pse duhet të regjistroni kompetencën tuaj?

Norvegjia ka disa zyra publike që punojnë për të udhëzuar personat në lidhje me arsimimin, trajnimin dhe punën. Ata kanë nevojë për informacione në lidhje me kompetencat tuaja për të ju udhëzuar në mënyrën më të mirë të mundshme.

Nëse do vendoseni me banim me asistencë publike, informacionet janë një nga disa faktorët që IMDI i merr parasysh kur zgjedh një komunë vendbanimi për ju.

Informacionet në lidhje me kompetencën tuaj do të shfrytëzohen më vonë për të ju dhënë udhëzime të përshtatshme për karrieren, qëllimin përfundimtar dhe përmbajtjen në programin tuaj hyrës.

Baza për trajtim

Baza ligjore për përpunimin e informacioneve mbi ju është Ligji i integritetit § 41 dhe Rregullorja e Integritetit § 47.

Informacion në lidhje me përmasën e regjistrimit

Personi që eventualisht ju udhëzon gjatë regjistrimit mund të futë detaje në rubriken për tekstet e tij të lira për të plotësuar informacionin që ju e regjistroni në Kompass. Në rubriken për tekstet e lira udhërrëfyese fut *vetëm* informacionët shtesë tek ato pika që i gjeni në Kompass.

Çfarë informacione rreth jush regjistrohen në Kompass:

- Shtetësia, gjinia dhe mosha
- Gjuhët që dini
- Shkollimi/arsimimi
- Eksperienca e punës
- Cilat aktivitete keni praktikuar të i bëni që janë të relevante për arsimimin dhe punën
- Interesat tuaja
- Dëshirat tuaja për arsimim dhe punë

Kush do të ketë qasje në informacionet që i regjistroni

Drejtorja për integrim dhe diverzitet (IMDI) ka përgjegjësi për informacione rreth kompetencës tuaj. IMDI poashtu ka depozituar emrin tuaj dhe numrin e referencës DUF, në mënyrë që mund të identifikojmë informacionet tuaja.

Qendrat e karrieres të lidhura me bashkinë e qarkut do të ofrojnë udhëzime për karrierën bazuar në informacione në lidhje me kompetencën tuaj. Kur do të jeni në grupin e synuar për programin hyrës, do të keni të drejtën dhe jeni të detyruar të perfundoni udhëzimet për karrieren. Një udhërrëfyese karriere do të përdorë informacionet rreth jush për të ju dhënë udhëzime më të mira të mundshme në lidhje me arsimimin dhe punën në Norvegji. Udhërrëfyese i karrieres do të ndajë rezultatin e udhëzimit me komunën, IMDI dhe NAV.

Enti Norvegjezë për Punë dhe Mirëqenies (NAV) mund të përdorë informacionet rreth jush për të ju dhënë udhëzime mbi mundësinë e gjetjes së punës në Norvegji.

Komuna në të cilë ndodhët vendpranimi do të përdorë informacionet rreth jush për të përshtatur programe me kohë të plotë ose për masa promovuese të integritit.

Nëse vendoseni me banim me ndihma publike, **komuna ku vendoseni** do të përdorë informacionet tuaja për të ju dhënë juve një program hyrës të përshtatshëm, trajnim në studime norvegjeze dhe shoqërore ose oferta tjera relevante të trajnimit. Informacionet mund të përdoren për **qëllime specifike kërkimore dhe statistikore**.

Cilat të drejta keni në rregullat e ruajtjes së privatësisë?

Ju keni të drejtë të shihni informacionet që janë regjistruar rreth jush. Ju keni të drejtë të kërkoni që informacionet që janë të pasakta të përmirsohen ose të fshihen. Ju keni të drejtë të kërkoni që informacionet rreth jush të mos përdoren, mes tjerash nëse besoni se janë të pasakta. Ju keni të drejtë të ankoheni për përpunimin e informacioneve.

Nëse dëshironi të ushtroni të drejten në lidhje me përpunimin e informacioneve tuaja, ju lutemi kontaktoni IMDI në adresën e mëposhtme të postës elektronike: post@imdi.no, ose drejtëpërdrejt protektorin e ruajtjes së privatësisë të IMDI në adresën e postës elektronike

personvernombud@imdi.no. Informacionet që i jepni do të depozitohen deri në 15 vjet.

Për më shumë informacione në lidhje me të drejtat tuaja ju rekomandojmë faqet e internetit të Inspektoratit të të Dhënave <https://www.datatilsynet.no/rettigheter-og-plikter/den-registrertes-rettigheter/>, dhe deklaraten e ruajtjes së privatësisë të IMDI <https://www.imdi.no/om-imdi/personvern/>.